

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Adriana Lima mahnit me pamjen e fundit dhe rrjetet sociale shpërthejnë! “Sikur u kthye...” Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/adriana-lima-mahnit-me-pamjen-e-fundit-dhe-rrjetet-sociale-shperthejne-sikur-u-kthye/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 04:57:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 23:04:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	46f631af78b6864f897609211a6735ea3967a8bd2a1178a617afe2ca2703a1ed
TEKSTI	ef00e195282052ffe00b774a2e47dd139bc7af7199e944d74f468e12756bc410
PAMJA	35aca94596b15267a94b25fe350872a008ccbf8aa42798722dc10d84f62d4f17

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04be28d8afb2fa4f19c1d12e2a9bb4ea46af14b14507337e732739b49be67fa2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04be28d8afb2fa4f19c1d12e2a9bb4ea46af14b14507337e732739b49be67fa2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Adriana Lima mahnit me pamjen e fundit dhe rrjetet sociale shpërthejnë! “Sikur u kthye...”





Redaksia K

23 Shtator 2026



Adriana Lima u shfaq në Madrid dhe mjaftuan disa fotografi për të rikthyer supermodelen në qendër të vëmendjes. Në moshën 45-vjeçare, ajo u shfaq me një pamje jashtëzakonisht të kuruar dhe fansat nisën menjëherë ta krahasojnë me imazhin e saj nga vitet e para të karrierës.





Lima mori pjesë më 18 shtator në festën përmbyllëse të Mercedes-Benz Fashion Week Madrid, të organizuar nga El Corte Inglés në Muzeun Kombëtar të Artit Reina Sofía. Ajo zgjodhi një fustan të zi elegant, flokët e mbledhur dhe një grim relativisht të thjeshtë.

Por ishte fytyra dhe pamja e saj e përgjithshme ajo që mori gjithë vëmendjen. Fotot nga eventi u përhapën me shpejtësi në rrjetet sociale, ku shumë përdorues e krahasuan Limën me versionin e saj të fillimit të viteve 2000.



Disa prej komenteve shkuan edhe më tej, duke pretenduar se modelja “nuk duket 45, por 25 vjeç”. Krahasimet me fotografitë e saj të vjetra u shfaqën në platforma të ndryshme, duke e kthyer paraqitjen e saj në një prej temave më të komentuar të modës gjatë ditëve të fundit.

Ndryshimi në pamjen e saj është vënë re edhe nga mediat ndërkombëtare. Vogue Arabia e përshkroi paraqitjen e re si një version më të skalitur të modeles, duke vënë në dukje vetullat e ngritura, nofullën më të theksuar dhe pamjen më të tonifikuar.





Megjithatë, komentet online kanë hapur edhe diskutime rreth mënyrës se si mund të jetë arritur ky ndryshim. Disa profesionistë të estetikës të cituar nga Vogue Arabia kanë speculuar për procedura të mundshme, përfshirë filler-at ose ndërhyrje të tjera estetike, por **Adriana Lima** nuk ka konfirmuar se ka kryer ndonjë prej tyre.

Vetë modelja ka folur edhe më herët për presionin që vjen nga komentet mbi pamjen e saj. Pas paraqitjes së saj në premierën e The Hunger Games në vitin 2023, kur disa persona komentuan ndryshimin e fytyrës së saj, Lima publikoi një selfie pa grim dhe shpjegoi se në atë periudhë ishte nënë e tre fëmijëve dhe kishte prioritete të tjera.

“Jam fytyra e një nëne të lodhur

- ishte mesazhi që ajo kishte përcjellë në atë kohë, duke iu përgjigjur komenteve mbi pamjen e saj.

Ndër vite, Lima ka folur gjithashtu për rëndësinë e aktivitetit fizik dhe kujdesit ndaj vetes. Pas lindjes së fëmijës së saj të tretë, ajo është raportuar se ka kombinuar stërvitjen me pesha, kardion dhe aktivitete të tjera fizike.

Paraqitja në Madrid vjen në një moment interesant për supermodelen, e cila vazhdon të jetë aktive në industrinë e modës edhe pas më shumë se dy dekadash në skenën ndërkombëtare. Në fillim të këtij viti, ajo ishte pjesë e fushatës së pranverës 2026 të Donna Karan New York, së bashku me Joan Smalls dhe Grace Elizabeth.

Ndërkohë, Lima pritet të rikthehet sërish në pasarelën e Victoria's Secret, duke e bërë paraqitjen e saj në Madrid edhe më të komentuar.

Në një industri ku pamja ndryshon vazhdimisht dhe mosha shpesh bëhet temë diskutimi, Adriana Lima vazhdon të tërheqë vëmendjen sa herë shfaqet. Këtë herë, një fustan i zi, flokë të mbledhur dhe një pamje e freskët mjaftuan që fansat të thoshin të njëjtën gjë:

“Sikur u kthye pas në kohë.

LAJME TË NGJASHME



Supermodelja Adriana Lima zbulon sekretin e formës së saj perfekte trupore në moshën 45-vjeçare!

1.5 MIN




Victoria's Secret rikthehet pas shumë vitesh! Një pasarelë mes nostalgjisë dhe ndryshimit, por cilat gra përfaqëson?

1 MIN



Iu “vodhën” para dhe informacione personale ndjekësve të Adriana Lima-s? Bien pre e një



Çfarë konsumon Adriana Lima gjatë ditës? Sekretet e dietës së saj!



Cilat janë modelet më të paguara 2024?

2 MIN

MË TË LEXUARAT



De Rossi ende nuk i jep minuta në Serie A mbrojtësit të Kombëtares shqiptare Mario Mitaj!



Premier League/ Manchester City është i pandalshëm, tre pikë edhe për Liverpoolin!



Serie A/ Fiorentina frenon Napolin në barazimin 1-1!



Dënimi i ish-krerëve të UÇK në Hagë, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Duhet hapa konkrete nga qeveria!



"Duhet të sillen mirë"/ Trump paralajmëron Iranin: Ose marrëveshje, ose do t'ju shkatërrojmë!



"E di që të kam frikë unë ty?!"/ Rrëfimi i rrallë i Hysni Zeles: Vajta ishte e jashtëzakonshme, na solli në mes të Tiranës, por edhe sot...



Kim Kardashian mahnit në galanë e muzeut të George Lucas!



Kalimtarit u plagos në atentat në Sarandë, 73-vjeçari dërgohet te Trauma në Tiranë!



"Mendonte t'i jepte fund jetës"/ Zbulimi tronditës i vëllait të Princeshës Diana për vitet e saj më të vështira!



Hashim Thaçi, njeriu i 17 Shkurtit nën hijen e 16 shtatorit!

EDITORI SUGJERON



Avokado apo gjalpë arrash në tost: cili ka më shumë proteina dhe fibra?!



5 ushqime që mund t'i hani me vitaminën D për përthithje më të mirë!



"Mashkulli që kërkon grua të virgjër..."/Rita Petro: Të bësh seks me dritë ndezur duhet të jesh shumë mendje hapur!



6 zakone të mëngjesit që mund ta përkeqësojnë kapsllëkun!



Çfarë ndodh kur hani mollë me gjalpë kikiriku?!



"Alessio më kthen fëmijën që kam brenda!" / Jonida Maliqi, 'jep leksion' për jetën, respekti mbi gjithçka: Mos abuzoni me titujt...



Bled Strakosha rrëfen përballjen me aneurizmën cerebrale: Kështu shpëtova jetën...



A ekziston vërtet fakti që uthulla e mollës ju bën mirë për shëndetin?!



Kujdes! Këto janë 4 ushqime dhe
pije që nuk duhen kombinuar
kurrë me ilaçet e diabetit...



Të hani galete orizi me gjalpë
kikiriku?! Ja se për çfarë do t'ju
ndihmojë...



TOP ALBANIA RADIO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.